



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**SHPLLJE PËR VENDET E LIRA PËR TË EMËRUARIT MAGJISTRAT NË  
VITIN 2022**

Datë 13.07.2022

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar emërimin e 22 (njëzetë e dy) magjistratëve të rinj të diplomuar në vitin 2022 nga Shkolla e Magjistraturës dhe me Vendimin nr. 187, datë 12.07.2022 ka shpallur vendet vakante që do të plotësohen nga këta magjistratë.

**Këshilli miratoi shpalljen e 22 (njëzetë e dy) vendeve të lira për caktimin e të emëruarve nga radhët e magjistratëve të rinj, si më poshtë:**

- |     |  |                   |
|-----|--|-------------------|
| 1.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës</b>       | <b>- 2 vende;</b> |
| 2.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë</b>     | <b>- 1 vend;</b>  |
| 3.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër</b>     | <b>- 4 vende;</b> |
| 4.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër</b>       | <b>- 2 vende;</b> |
| 5.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin</b>      | <b>- 1 vend;</b>  |
| 6.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë</b>       | <b>- 1 vend;</b>  |
| 7.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje</b>     | <b>- 1 vend;</b>  |
| 8.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat</b>       | <b>- 1 vend.</b>  |
| 9.  | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë</b>       | <b>- 3 vende.</b> |
| 10. | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec</b>    | <b>- 1 vend.</b>  |
| 11. | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër</b> | <b>- 2 vende.</b> |
| 12. | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë</b>       | <b>- 2 vende.</b> |
| 13. | <b>Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë</b>     | <b>- 1 vend.</b>  |

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shpalljen e këtyre vendeve referuar ligjit Nr.96/2016, fton magjistratët e rinj, profili prokuror, të diplomuar në vitin 2022 dhe të emëruar magjistrat nga KLP, që brenda një jave nga publikimi i kësaj shpallje, të dorëzojnë në Këshill dakordësinë e arritur ndërmjet magjistratëve për plotësimin e këtyre vendeve. Nëse pas këtij afati dakordësia nuk është arritur, magjistratët duhet të paraqesin pranë KLP-së një kërkesë me shkrim ku të tregojnë parapëlqimin e tyre për 3 (tre) prej vendeve vakante të shpallura, sipas renditjes preferenciale, por jo më vonë se dy javë kalendarike nga publikimi i shpalljes.